

*Ndreko Rino*



*ZAMBAKË  
TË KUQ*


*vjersha*

834-1  
R 76.

*Ndreko Rino*

**ZAMBAKË  
TË KUQ**

*vjersha*



**Redaktor**

PERIKLI JORGONI

## *Bisedë me Drinin*

- Ç'ke, o lumë, o lumë i gjatë,  
që po vjen i turbulluar?  
— Plot tri herë për pak mote  
udhën time kam ndërruar.
- Ç'ke, o lumë, o lumë i thellë,  
nga të vjen kjo zhurmë e madhe?  
— Rrjedhën time ma kanë prerë  
këto diga sa tri male.
- Ç'ke, o lumë, o lumë plot dallgë,  
mos na qenke zemëruar?  
— Jo, poet, të dukem ty,  
unë vij duke kënduar.

Eja, pra, këndofsh gjithmonë!  
Kënga jote — dritë e artë,  
ngulen flamujt e fitores  
përngaherë dhe më lartë.

## *Fjala e ngrohtë e Partisë*

Prilli ishte pesëmbëdhjetë,  
eh, ç'tërmet i madh që ra!  
Edhe foshnjëzat u drodhën,  
thoshe toka dysh u nda.

Shpejt Partia lëshoi thirrjen  
nga Bistrica, te Valbona,  
të gjithë në këmbë u ngritëm,  
njësh u lidhën zemrat tona.

Dhe u sulëm, derdhëm djersën,  
si dje gjakun në beteja,  
e me vrulle heroike  
bëmë mjaft fshatra të reja.

Frymëzim e forcë na fali  
fjala e ngrohtë e Partisë;  
jo, nuk ka tërmet në botë  
t'i tundë bijtë e Shqipërisë!

## Ç'ka Valbona e kaltër

Ç'ka Valbona e kaltër,  
pse është egërsuar?  
Vallë, cili trim  
vdekjen ka përçmuar?

Emrin po ia thotë  
këngë e trimërisë,  
qenka Ramë Sadria,  
biri i malësisë!

Bjeshka shushurin,  
shushurin Valbona,  
s'ka të reshtur kënga,  
endet larg jehona.



Larg në kohë e breza  
do të rrojë ajo,  
do na sjellë në sy  
trimin tonë hero.

Emrin kufitar  
meriton me nder,  
përmbi diversantët  
ngjalli vetëm tmerr.

Ti, buçit, o këngë,  
në male e brigje!  
Kufitarët janë  
shqipe nëpër shtigje.

Shqipe është Rama,  
shqipe në murlan,  
se heronjtë kurrë  
vdekje, jo, nuk kanë!

Rrojnë e mbajnë zgjuar  
shtigjet edhe shpatet,  
në jetën e popullit  
jeta e tyre zgjatet.

## *Dimër i vitit 1944*

Bora binte me shtëllunga,  
era çirrej si e marrë,  
partizanët mes tufanit  
këngës fort ç'ia kishin marrë!

— Dil, moj nëno, — thirri djali, —  
dil të shohësh sa shumë janë!  
Është shpifje tradhëtarësh  
se s'kanë mbetur partizanë. —

— Dola, bir, të keqen nëna!  
Zemra mal më bëhet sot.  
Le të grijnë korbata ç'të duan!  
Diellin s'e mbulojnë dot!

Pas rrebeshit e furtunës  
dhe më bukur ai ndrin;  
po afrohet Dita e Madhe,  
mu në prag kemi lirinë! —

## *Të gjithë djem azganë*

*Brigadës së 24-t Sulmuese*

Sot po qesh mal' i Gjalicës,  
Drini i Zi me të vëllanë,  
petka feste kanë veshur  
Shtiçen, Nangë e Kolosian.

Dhe faqet e Kallabahut,  
Kalaja bashkë me Surojnë.  
Luma, Borja Shishtaveci,  
që të gjithë sot gëzojnë.

Hapet lajmi si rrufeja,  
në Bicaç, në një lëndinë,  
bijtë e Lumës e të Kukësit  
sot po formojnë njësinë.

Ngrehu, o Ramadan Zaskoçi,  
të shohësh nipat, djemtë azganë,  
si luftojnë buzë Drinit,  
te Kulla si lënë namë!

Jo, Brigada s'e ndal hapin,  
sulen trimat nëpër shqotë,  
që nga Kukësi në Tiranë,  
që nga Shkodra gjer në Hot.

Dhe drejt Alpeve përpjetë,  
ajo çan në suferinë,  
vdekjen t'i sjellë armikut,  
edhe popullit lirinë.

## Yll në mes të yjeve

Biri i Veleshnjes,  
Zylyftar, vëlla,  
qysh i ri maliherin  
hodhe ti në krah.

Maleve të thirri  
zëri i Shqipërisë,  
Zylyftar Veleshnja,  
djalë i vegjëlisë!

Ti për mëmëdhënë  
kurrë s'u kurseve,  
plot duf më njëzetën  
pushkën ç'e rrëmbeve!

Mbi armiqtë qena  
derdhe plumba shumë,  
si zgalem i shpejtë  
ishe në furtunë.

Ç'të ndoqi Zogolli,  
pas kufirin le,  
po me mendje e zemër  
mbete në atdhe.

Ndaj sërish u ktheve,  
Zylyftar, o trim,  
do të kish atdheu  
përsëri kushtrim!

Kur më 8 Nëntor,  
yje mbi ne ndritën,  
populli, Partia,  
pranë të thërritën.

Pushkën prapë e zbraze  
ti, në vijë të parë,  
yll në mes të yjeve,  
trim, o Zylyftar!

## *Nënës veterane*

Mëmëzë e dashur,  
ballin mbushur rrudhë,  
fëmijninë e varfër  
s'e harroj dot kurrë.

Sa u rrita pakë,  
mbusha dymbëdhjetë,  
ty t'u bëra krahë  
në punë e në jetë.

Së bashku punonim  
në fushë e në arë,  
të dy korrnim grurë  
nëpër agallarë.



Të dy ishim pranë,  
ku lufta kërciste,  
unë partizan  
e ti aktiviste.

Dhe erdhi liria  
me yllin në ballë,  
po prapë Partia  
na deshi ushtarë.

Dhe s'u lodhëm kurrë  
tok duke punuar,  
se gjithçka nga rrënjët  
na duhej ndryshuar.

Po një ditë ike  
si drita në mbrëmje...  
Ty në shpirt të kam,  
të sjell shpesh në mendje.

Dhe ta dëgjoj zërin  
shpesh në ëndërrime,  
nënë duararta,  
nënë zemërtrime!

## *Gaz dhe hare*

Shkuan vite plot përpjekje,  
vendi qesh si nuse e re,  
nga e nisëm këtë udhë  
s' e harrojmë kurrë ne!

Rronim ndër kasolle kashte,  
nëpër zheg e nëpër shi,  
na shtypte xhandar e bej,  
dhe punonim si çifçi!

Dhe në gji mblidhej urrejtja  
si një det plot me furtunë,  
na rëndonte skllavëria,  
ajo shtypje, ajo dhunë!

SHITE  
~~8098~~  
13696

Ndaj shpërtheu nga dheu stuhia,  
krisi pushka për çlirim,  
u ngrit bujku e punëtori,  
të mos kishte më mjerim!

Tani rrojmë të gëzuar  
në atdheun tonë të lirë,  
ku ke gaz që të punosh  
plot me vrull edhe dëshirë.

Dhe nga shpirti buron kënga  
dhe si zogu fluturon,  
e dëgjon guri, dhe dheu  
çel sythe e lulëzon!

Ndrin ngado kjo lumturi,  
që na solli ne Partia,  
pleqëria flaket tutje,  
gaz, hare njeh Shqipëria!

## *Fshatit tim*

Fshatin tim të dashur,  
vendin ku kam lerë,  
e kujtoj me mall,  
e kujtoj ngaherë.

Me shtëpi përdhese,  
(jetë, o jetë e shkretë!),  
pak përshesh me dhallë,  
pakëz bukë e qepë.

S'e harroj aganë,  
as dhe taksidarët,  
kur në derë trokitnin,  
kishin pas xhandarët.

Fushës para fshatit,  
sa vinte pranvera,  
bridhnim këmbëzbathur  
si oqiçë, shqerra.

Dimrave të egër,  
me dëborë, acar,  
mbledhur rrotull verës  
me një dorë zjarr.

«Eh, behari është  
mik për fukaranë!» —  
gjithnjë ballëvrenjtur  
thoshin pleqtë tanë.

Fshatin tim të dashur  
shpesh e vizitoj,  
vegjëlinë tonë  
nxënësve u tregoj.

## *Yje të pashuara të lirisë*

Pranë tyre jemi çdo 5 Maj,  
plot nderim nën qiellin tonë të lirë,  
dhe në zemrat tona çel petalet  
mall i bijve tanë më të mirë.

Ngrihuni, vëllezër, pak në këmbë,  
shiheni ju nuse Shqipërinë,  
gjaku juaj është në flamur,  
ëndrrat tuaja kudo na ndrijnë!

## *Yll karvani në kufi*

*Kushtuar pesë kufitarëve dëshmorë të  
Dobërdolit*

Bardhok Jaku, djalë pukjan,  
u prin shokëve në ballë...  
Janë pesë djem petritë,  
që ecin nëpër murlan.

Egërsohet moti shumë,  
era çirret si e marrë,  
por ata mes borës çajné.  
të zënë shtegun sa më parë.

I sheh Qafë e Ali Çelës  
tek nxitojnë, e bën çudi,  
«Kësi trimash, — sikur thotë, —  
rrallë njohën sytë e mi!»

Bredh murlani nga Sublica  
e gjer tej në Dobërdol...  
Eh, s'tregohet dot me gojë!  
Fol, moj zemra ime, fol!

Kufitarët që të pestë  
drejt detyrës heshtas çajnë,  
i dëftejnë murlanit gjoksin,  
përmbi shpinë ortekët mbajnë.

Kufitarët që të pestë  
dhanë jetën në rini,  
heroizmi i tyre mbetet  
yll karvani në kufi.



## *L o l ë s*

*(Dëshmoret Floresha Myteveliu)*

Porsi lule, Lolë, ishe,  
kur na erdhe në brigadë,  
vajzë e vogël, debatikase,  
syshkëndijë e zemërzjarrtë.

Dibra kurrë s'të harron  
qysh u sule si rrebesh,  
përkrah trimave shqiponjë,  
moj e vogëla Floreshë!

Plumb i snajperit barbar  
gjoksin tejpertej e shpoi,  
porse sulmin tënd të vrullshëm  
s'pati forcë ta ndalojë.

Me trupin mbushur me plagë,  
u turre pa ndjenjë frike,  
deshe si Selam Musai  
topin ta zije për gryke...

Por të zunë e të mbyllën  
në një burg, në Strugë, trime!  
Në tortura të munduan,  
me kamxhik e me mundime.

Goja kyçur, sytë s'flisnin!...  
Dridhej frici skuqur flakë,  
thosha: «Kjo vajzë komunizmin  
e ka të tretur në gjak!»

Prandaj ti, dhe pas kaq motesh,  
në mes nesh mbetesh e gjallë,  
lule e kuqe e lirisë,  
trimëreshë me yll në ballë!

## «*Avanti, Giovani!*»<sup>1)</sup>

*Terzilio Kardinalit –*

Ky zë i njohur dhe kjo thirrje  
kanë mbetur gjallë në kujtesë,  
imazhin tënd, o Kardinal,  
jo, kurrë koha s'do ta tresë!

E ruajnë thellë zemrat tona,  
malet e shtigjet nga kalove;  
e ruajnë shokët partizanë,  
se krah për krah me ta luftove!

---

1) Përpara, djema!

Kjo këngë e thjeshtë buron vetë,  
ndaj ty ta falim me nderim,  
me bujarinë arbërore,  
si për një mik, si për një trim!

Na lidhi bashkë ideali,  
na lidhi lufta në një front;  
na lidhi gjaku i kulluar  
që derdhe ti, i shtrenjti shok!

Na del përpara ashtu i qeshur,  
duke çarë shtigjet përpjetë,  
«O shokë, — thoshe, — veç mes jush  
e gjeta rrugën e vërtetë...»

Si trim luftove në Çereneç,  
me një beretë përmbi brez,  
dhe shall i kuq i partizanit  
ej, ç'nur të kish atë mëngjes!

U hodhe... zëri të gjëmoi:  
«Avanti!» — thirre gjithë zjarr,  
por plumb i hidhur i armikut  
ta preu sulmin, Kardinal...

T'u mblodhën shokët të të ngrinin,  
e ti u the të fundit fjalë:  
«Avanti, giovani, e mos më qani,  
se unë po vdes për ideal!...»

## *Ti ishe zog shqiponje*

*Heroinës së Popullit Ylbere Bilibashi*

Në udhët e vështira  
të luftës së gjatë  
lëshonte dritë agimi  
gjithnjë për ne Partia,  
ndaj hapi yt përherë  
kish siguri, o bijë,  
ndaj ty të buzëqeshte  
me gaz ngado liria.

Ti mbete shoqe e denjë  
në rreshtat e lavdisë,  
e shpejtë-o-suferinë,  
e dimrit si burbuqe,  
ti, porsì lulja e parë

që lajmëron pranverën,  
tregoje se ish afër  
liria jonë e kuqe.

Dhe rritej-rritej-rritej  
më shumë besimi yt,  
të ardhmen qartë e shihje,  
mes ngricash, tek po lindte,  
kur kriste pushka jote  
ndër gërxhe me furi,  
e kur ajo zemër e vogël  
për hasmin s'desh t'ia dinte.

Ti zog shqiponje ishe  
në malet tona të lashta,  
ti zog shqiponje ishe  
gjer larg-o, në Deçan;  
t'u sulën me rrëmbim  
një ditë armiqtë e egër,  
por shpinën tënde, jo,  
një çast ata s'e panë.

Tek mbete e përgjakur,  
e shtrirë në dëborë,  
me ashpërsi vështrove  
tre qentë, tre nazistët,  
thërrite «Poshtë fashizmi!»

me gjithë forcën e shpirtit,  
thërrite «Nuk i tremben  
as vdekjes komunistët!»

Dhe heroizmi yt  
në histori u shkrua  
me gjakun tënd të pastër,  
të kuq e të kulluar;  
përpara sysh të kemi,  
gjithnjë tani, moj lule,  
ashtu të bukur, trime,  
si shqipe krahëshkruar!



## *Në rrugët tona ndrin*

E varfra jeta jonë,  
nga hallet e rënduar,  
sa herët, Gjok', o lule,  
të kishte burrëruar!

Kur bije mbi nazistët,  
rrufeja sikur binte,  
e zjarra armë në duar  
sa rreptë shkrepëtinte!

U sule si fajkua  
atë mëngjes nëntori,  
por gjoksi yt i flaktë  
një breshër plumbash mori.

S'u dhe, në këmbë qëndrove,  
armiqve prapë iu sule,  
flamurin për fitore  
një mal më lart e ngule.

U drodh i gjithë vendi,  
kur lajmi u shpërnda  
se Gjoka s'është më,  
se Gjoka jetën dha.

Sa vite kanë rrjedhur,  
o Gjok', qysh atëherë...  
Është bërë Shqipëria  
si kopshti në pranverë.

Në rrugët tona ndrin  
si dielli i pastër sot  
dhe gjaku që ti derdhe  
atë të ashpër mot.

## *Goxho Ali Nikaj*

Ish një yll që shkrepëtiu  
qysh në Vlorë, më dymbëdhjetën,  
Goxho Nikaj ia thonë emrin,  
s'e kurseu kurrë jetën.

Lab i thjeshtë, ndonëse plak,  
pushkën kapi përsëri,  
drita e dritës së Partisë  
iu ndez flakë e zjarr në gji.

Nëpër rreshtat partizanë  
prapa djemve një herë s'mbeti,  
e në vijë të parë të sulmit  
forcë të riu gjithnjë gjeti.

Dhe te djali i Goxhos rridhte  
lirshëm-lirshëm veç gjak trimi;  
në Brigadë të Pestë ish plaku,  
në të Parën qe Selimi.

Aq sa larg, aq edhe afër,  
me një zemër, ideal,  
gati tok ta jepnin jetën,  
pa merak, si babë e djalë.

Dhe e dhanë duke qeshur,  
në një këngë të dy rrojnë,  
nëpër festa e fitore  
at' e bir me ne gëzojnë.

## *Asim Zenelit*

Dhe rrodhi një këngë si uji i Vjosës,  
dhe hyri në zemrat tona nëpër gjak.  
Me emrin tënd ne ecëm nëpër shtigje,  
me ty u hōdhëm në tym e në flakë.

Dhe nuk e harruam ta këndojmë këngën:  
«Një zë po del nga gryka e Mezhgoranit»,  
gjersa një ditë të bukur të nëntorit  
lirinë e zbritëm lart nga maja e malit.

Sërish këndojmë me zë të plotë këngën:  
«Shoku Asim del jashtë nga istikami».  
Ti ike, edhe mbete midis nesh  
një bir i mirë i këtij vatani.

## *Për ty, komisar*

Unë, Shemja, që ti e doje shumë,  
e dru mbaja kaq vite me gomar,  
marr në duar kalemin që të shkruaj  
një këngë për ty, o shoku komisar!

Me ato shkronja që ti më mësove  
shteg me shteg rreth zjarrit partizan,  
përmbi letër i radhit këto vargje  
siç radhitnim fishekët në gjerdan.

Dhe shkruaj e shkruaj, por dot nuk i them  
të gjitha ç'më ndien zemra para bustit tënd,  
tok me lulet që solla në shenjë kujtimi për ty,  
po lë, komisar, si kujtim këtë këngë!

## *Lumja unë*

*Nënës së partizanit dëshmor*

Er dhën shokët e të thanë:  
«Djali yt në luftë ra...»  
Ti vështrove tej nga mali  
e u ktheve nga ata.

«Pra, hə, djema, më tregoni,  
bir i nënës si luftoi?  
Plumbi mu në ballë e mori  
apo prapa e qëlloi?»

T'u përgjigjën me një zë:  
«Jo, nëno, e kishe burrë.  
Nuk u tund nga istikami,  
syri tër s'ia bëri kurrë...»

Ngrite kokën ti sërishmi  
me vështrimin tej nga mali,  
«Lumja unë, — pëshpërite, —  
ma ka zbardhur faqen djali!»

«Hallall gjirin, — u the shokëve, —  
hallall bukën, dashurinë!  
Birin tim me lot s'e qaj,  
se m'u vra për Shqipërinë.»



## *Çerçiz Topulli*

Një lajm i hidhur u dha,  
Çerçiz Topulli u vra.  
Vranë Çeço kapedanë,  
plumbi ku e mori vallë?

Ra e ra theror si burrë  
trimi që nuk u tremb kurrë.  
Për të e për Mustafanë<sup>1)</sup>  
me ligje malet seç qanë.

---

1) Mustafa Qulli

Trego ti, moj Mashkullorë,  
si luftoi me armë në dorë?  
Sopot, Lekël, Lunxhëri,  
ku s'u shkrep koburja e tij!

Ai rron mbi male e kodra,  
nga Gjirokastra, te Shkodra.  
Majë mbi çdo majë të lartë,  
Çeço trimi zemërzjarrtë!

«Çeçoja revol' me dhjetë,  
shtiu shtatë e vrau tetë.»

## *Pashko Vasës*

*Ditën e sjelljes së eshtrave në atdhe*

Porsi nuse e stolisur  
nga Kalaja del Rozafa,  
për t'i dhënë lajmin Shkodrës  
se po kthehet Pashko Vasa.

Vjen poeti i «Shqipnisë»,  
vjen krenar dhe po gëzon,  
si në maj toka mëmë  
tejmbanë lulëzon.

Hyn në odën e kuvendit,  
prej nga iku aq i ri...  
Eh, që s'çohet dot në këmbë!  
Eh, që prapë të flasë s'di!

Vasha-yje e djem petritë  
radhas vijnë ta nderojnë,  
ç'mallëngjim në zemra kanë!  
Sa shumë duan t'i tregojnë!

Porsi nuse e stolisur  
nga Kalaja del Rozafa,  
për t'i dhënë lajmin Shkodrës  
se po kthehet Pashko Vasa.

## *Çohu, trim!*

Çohu, trim, Hasan Prishtina,  
na ke nipër, jemi ne.  
na dërgoi te ti Partia,  
të të marrim në atdhe.

Këto lule i këputëm  
në lulishtet, në Tiranë,  
erë të ëmbël Shqipërie,  
erën e atdheut kanë.

Ndenje shumë në dhe të huaj,  
rrodhën vite, s'të kemi parë,  
baltën e atdheut tënd  
mall' i zjarrtë ç'e ka marrë!

Shqipëria dhimbje ndjeu,  
kur të vrau në Selanik  
mbreti djall Ahmet Zogolli  
me lakejtë, o kreshnik!

Lule, trim, Hasan Prishtina!  
jemi nipër, jemi ne,  
bashkë me dëshmorët e tjerë  
të mban populli në atdhe!

## PASQYRË E LËNDËS

Bisedë me Drinin .....	3
Fjala e ngrohtë e Partisë .....	5
Ç'ka Valbona e kaltër .....	7
Dimër i vitit 1944 .....	9
Të gjithë djem azganë .....	11
Yll në mes të yjeve .....	13
Nënës veterane .....	15
Gaz dhe hare .....	17
Fshatit tim .....	19
Yje të pashuara të lirisë .....	21
Yll karvani në kufi .....	22
Lolës .....	24
«Avanti, Giovani!» .....	26
Ti ishe zog shqiponje .....	29
Në rrugët tona ndrin .....	32
Goxho Ali Nika .....	34
Asim Zenelit .....	36
Për ty, o komisar .....	38
Lumja unë .....	39
Çerçiz Topulli .....	41
Pashko Vasës .....	43
Çohu, trim! .....	45

Rino, N.

Zambakë të kuq. Vjersha. [Red.: P.  
Jorgoni], T., «Naim Frashëri», 1982.

48 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

R 76

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash 2204-79

Shtypur KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1982.